



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**  
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 23.11.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 20.11.2023, të parashtruar nga operatori ekonomik INFINITT SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ritender "Furnizim me inventar dhe pajisje për Njësitë Shëndetësore të Burgjeve"** – LOT 1, me numër prokurimi 206-23-10633-1-2-1, nxjerr:

**V E N D I M**

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e operatorit ekonomik INFINITT SH.P.K. e dt. 20.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ritender "Furnizim me inventar dhe pajisje për Njësitë Shëndetësore të Burgjeve" – LOT 1, me numër prokurimi 206-23-10633-1-2-1, kundër *Njoftimit mbi Vendimin e AK*, të datës 14.11.2023 të publikuar në platformën elektronike;
2. **Mbetet në fuqi**, Njoftimi mbi Vendimin e AK, i publikuar me datë: 14.11.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**A r s y e t i m**

Operatori ekonomik INFINITT SH.P.K. me datë 20.11.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ritender "Furnizim me inventar dhe pajisje për Njësitë Shëndetësore të Burgjeve" – LOT 1, me numër prokurimi 206-23-10633-1-2-1. Autoriteti Kontraktues menjëherë është marrë me shqyrtimin e kërkesës në fjalë dhe në bazë të dokumentacionit të lëndës, sot me datën 23.11.2023, vendosi si më poshtë:

**Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:**

*Neni 1 – Qëllimi*

*Neni 7 – Barazia në trajtim / jo diskriminimi*

*Neni 28 – Specifikimet teknike*

*Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve*

~~Neni 60 – Kriteret për dhënie të kontratës~~

~~Neni 19 i UOPP-se Specifikimet teknike~~

~~Neni 41 i UOPP-se Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve~~

#### Pretendimi ankimor

AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë - LOT1 nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik.

AK/zyra e prokurimit me 14.11. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar per kontrate OE Europrint Group sh.p.k.

Qasje ne dokumente zyrtare kemi kerkuar me 14.11. dhe AK na ka aprovuar qasjen per daten 17.11.

Nga dokumentet e OE te rekomanduar per kontrate te cilat kemi pranuar nepermjet USB ne qasjen ne dokumente zyrtare konstatojme se AK/komisioni vleresues ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem per LOT1 pasiqe sipas katalogut te dorezuar nuk ploteson specifikimet teknike per pozicionet 5, 7 ne specifikacionin e tenderit.

OE i rekomanduar per kontrate nuk ka pergaditur katalog te leshuar nga ofertuesi por ka mare copy paste specifikimet e vendosura nga AK ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit.

Per pozicionin 5 AK ka kerkuar treules (kauq) ndersa OE sipas fotos se prezentuar ka ofertuar dyules.

Per pozicionin 7 AK ka kerkuar varesë per rroba standarde nga materiali i drurit ngjyre te kaftë ndersa OE i rekomanduar ka ofruar varesë per rroba nga materiali mesing siq shihet ne foton e prezentuar dhe ngjye ari.

Bazuar ne faktet e lartecekura konstatojme se AK ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem i cili nuk ploteson specifikimet teknike per pozicionet 5, 7 ne paramase.

#### Dëmet materiale

Si pasoje e shkeljeve te lartecekura nga AK/komisioni vleresues ka ardhë deri tek dhenia e kontrates per OE te papergjegjshem, ne kete menyre na eshte mohuar fitimi simbolik i paramanduar nga kjo kontrate dhe nuk eshte respektuar neni 60 i LPP-se qe kontrata ti ipet kompanise sone si tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet.

Kerkojme nga zyrtari pergjegjes i prokurimit qe pas shoshitjes se provave dhe fakteve te aprovoje ankesen (kerkesen per ri-shqyrtim) si te bazuar dhe lenda per LOT1 te kthehet ne ri-vleresim ne te kunderten jemi te obliguar te dorezojme ankesë ne OSHP.

#### Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore te OE ankues:

Ne si AK-MSh nuk pajtohemi me pretendimet e juaja ankimore dhe Kërkesën tuaj për rishqyrtim e konsiderojmë si te pa bazuar.

Është i pa bazuar dhe i pakuptimtë pretendimi juaj ankimor se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka përgatitur katalog te lëshuar nga ofertuesi por ka mare copy paste specifikimet e vendosura nga AK ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit, për dy arsye:


Arsyeja e parë: ne NJK dhe DT nuk është kërkuar vetëm katalog, por është kërkuar katalogu (broshura) – shih kriterin e tenderit: **Dëshmia 2. Katalogu (broshura) e pajisjeve te ofruara me selektim te qarte te inventarit dhe paisjeve shtepiake dhe specifikave teknike te ofruara.**

Arsyeja e dytë: Si mund ta atakoni broshurën e operatorit tjetër (te rekomanduar) përderisa me te njëjtën forme broshure keni ofertuar edhe ju vet.

Edhe broshura juaj e ka përshkrimin e artikullit 5 dhe 7 copy-paste nga specifikimi i ANEKS 1 te dosjes se tenderit, shih fotot e broshurës tuaj.



	<p>Treules (kauq) me mbështetës të shpinës dhe duarve në të dy anët, me mundësi të shtrirjes (dimensionet 220x90x84 cm, ngjyre kafe e mbyllet)</p>  <p>Pos.5</p> <p>Karrige e rrumbullaket pa mbeshtese rrotulluse per patient</p>
--	--

	<p>Varse për rroba-standard materiali prej druri, ngjyre e kafej</p>  <p>Pos.7</p>
--	--

Është i pa bazuar pretendimi juaj ankimor për pozicionin 5 se AK ka kërkuar treules (kauq) ndërsa OE sipas fotos se prezantuar ka ofertuar dyules, meqenëse OE i rekomanduar ka ofertuar me kauq me dimensione siç janë kërkuar 220x90x84 cm, me një ndarje ne mes, e cila ndarje nuk do te thotë se kauqi është dy ulës, meqenëse kauqin dy apo tre ulës e përcaktojnë dimensionet e jo forma e ndarjeve siç ju pretendoni. Edhe kauqi juaj ne foton me larte është pa asnjë ndarje, por vetëm me qepje ne 6 fusha, atëherë si mund ta konstatojmë ne se është tre ulës, përveç nga dimensionet.

Është i pa bazuar pretendimi juaj ankimor për pozicionin 7 se AK ka kërkuar varesë për rroba standarde nga materiali i drurit ngjyre te kafe ndërsa OE i rekomanduar ka ofruar varëse për rroba nga materiali mesing siç shihet ne foton e prezantuar dhe ngjyre ari, meqenëse OE i rekomanduar ka ofertuar me produktin e njëjtë si ne specifikimin e Aneksi 1 te DT.

Përmes sqarimeve shtese te datës 09.10.2023, ne lidhje me varësen te pozicioni 7, ne si AK e kemi sqaruar dhe kemi potencuar se: **Ju lutem që të referoheni vetëm sipas specifikave të kërkuara. Mbetet specifikimi i kërkuar ne Dosje te tenderit (Aneksi 1).**

OE i rekomanduar ne broshure e ka përshkrimin siç është kërkuar: **Varse për rroba-standard materiali prej druri, ngjyre e kafe.**

Nga Njësia e Kërkesës është bere një gabim teknik ne specifikacion tek ky artikull, meqenëse ndryshon specifikimi tekstual me foton e kërkuar, por ky konsiderohet si devijim i vogël, kur merret parasysh se ky artikull është minor ne krahasim me tere listën e produkteve.

Për pozicionin 7 te dy ofertat e keni dhënë çmimin e njëjtë (15 x 15) = 225.00 euro.

Oferta juaj ne total është 15,960.00 euro ndërsa oferta e OE te rekomanduar është 14,420.00 euro.

Bazuar ne nenin 1 te LPP-se, ne e kemi rekomanduar për dhënie te kontratës ofertën me çmimin me te lirë, me e lire se sa oferta juaj për **1,540.00 euro**.

OE i rekomanduar ne ofertën e tije ka ofruar edhe Deklaratën për specifikacion si me poshtë:



## DEKLARATË E SPECIFIKACIONIT

*Me anë të kësaj shkrese ne kompania EUROPRINT GROUP SHPK me nr.biznesi 810860587 deklarojmë se ne do iu permbahemi kushteve , specifikave teknike dhe afatit të liferimit sipas dosjes së tenderit të shpallur nga Autoriteti Kontraktues :*

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr i prokurimit	206-23-10633-1-2-1
Nr i brendshëm	

Titulli: Ritender " Furnizim me inventar dhe pajisje për Njësitë Shëndetësore te Burgjeve"

DEKLAROJM SE PRODUKTET QE DO TI SJELIM NE RASTIN E MARRJES SE KONTRATES DO TE JENE KONFORM SPECIFIKAVE TEKNIKE DHE PERPUTHEN ME ATO TE PERMENDURA NE ANEKSIN 1 TE DOSJES SE TENDERIT. LIFERIMI I MALLIT DO TE JETE SIQ ESHTË KERKUAR NGA A.K 30 DITE  
I GJITH MALLI DO TE KETE NJE GARANCION SIQ ESHTË KERKUAR NGA A.K



<sup>1</sup> Te raportohet në çdo dokument apo kërkesë ne lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Është hera e trete qe ky aktivitet tenderohet, edhe herën e kaluar ju jeni ankuar dhe ne i kemi pranuar pretendimet e juaja ankimore, andaj presim nga ana juaj qe mos ta bllokoni këtë aktivitet, i cili për nga vlera nuk është i madh, por është mjaft i rëndësishëm, meqenëse përmban artikuj te cilët janë shume te nevojshme për njësite shëndetësore ne qendrat e burgjeve te Republikës se Kosovës.

Ky aktivitet përmban rafte dhe dollapë për vendosjen e barnave, te dokumenteve shëndetësore dhe te gardërobës për stafin mjekësor qe operon ne këto qendra, andaj për MSh-ne është shume me rëndësi qe sa me shpejte te behet furnizimi i tyre.

Ne u sigurojmë se gjate furnizimeve te këtyre produkteve AK do te jete i vëmendshëm qe te gjithë artikujt te jene sipas specifikave te kërkuara, për këtë gjë mund te njoftoheni edhe ju me kohe.

Ne baze te sqarimeve te mësipërme, kërkesa juaj për rishqyrtim është e pa bazuar dhe mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK i publikuar me datën 14.11.2023.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

**Vendimi i dorëzohet:**

1. Infinitt SHPK
2. Operatoreve ekonomik te interesuar



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit